



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ . 2024

SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti i prokurimit: “Blerje pajisje për mobilim”

1. Karrige Fikse



Karrige me bazament të palëvizshëm, pa krahë me përmasa 54x58x81cm. Kjo karrige duhet të ketë një veshje prej cope ngjyrë të zezë, ndërsa mbushja duhet të jetë sfungjer. Duhet të ketë një pamje bashkohore me një punim cilësor dhe gjithashtu duhet të jetë komode dhe e qëndrueshme në kohë.

2. Raft garderojë për stafin (standard dy kapakësh)



Raft garderojë për stafin e edukatorëve: Thellësia: 52 cm; Të ketë ndarje me sergjenë dhe kapaku tjetër të jetë i përshtatshëm për varjen e rrobave në varëse; Ngjyra: të kombinohet me raftet e lodrave dhe garderojën e fëmijëve; Lartësia: 205 cm; Numri i sirtarëve: 2; Gjerësia: 80 cm; Kapakët me bravë. Skeleti + sergjenët të jenë e njëjta ngjyrë.

3. Raft për vendosjen e lodrave

Raft për vendosjen e lodrave me përmasa 200cm x 40cm x 80 cm. Struktura: melaminë 16mm me veshje perimetrale PVC, ngjyra e bardhë. Është funksional dhe në të mund të vendosen kasone të ndryshëm plastik të mbushura me lodra fëmijësh. Duhet të ketë një pamje bashkohore dhe një punim cilësor. Materialet që duhet të përdoren në prodhimin e raftit nuk duhet të jenë alergjik dhe të dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.



4. Raft Garderobë

Raft për vendosjen e rrobave me përmasa 120cm x 40cm x 40cm pjesa e poshtme dhe 120cmx10cmx80cm pjesa e sipërme. Materiali me të cilin duhet të realizohet rafti është m.d.f. ngjyrë druri natyral. Duhet të ketë një pamje bashkohore dhe një punim cilësor.



5. Blender për fruta/perime

Blender për fruta dhe perime. Fuqia 800 Ë. Sistem tehu i ndashëm: Montimi i teheve të lëvizshëm lejon pastrim të lehtë. Materiali inoks, ndërsa materiali i gotës të jetë plastike. Të ketë garanci 12 muaj.



6. Makinë grirëse për mishin



Makinë grirëse për mish. Fuqia 1500 Ë. Numri i disqeve: 3. Materiali i jashtëm është plastik, ndërsa pjesët e montimit inoks. Të ketë garanci 12 muaj.

7. Sobë profesionale

Sobë profesionale për kapacitete +100 fëmijë, me 6 vatra për gatim, ku 4 janë me korrent dhe 2 me gaz. Furra të jetë me korrent. Me ose pa ventilim. Volumi 1-1.5 m³.



8. Tavolinë Rrethore Ngrënie

Tavolinë rrethore me diametër 60cm, për ngrënie për fëmijë të moshës së çerdhes. Këto tavolina duhet të jenë me ngjyra të ndryshme. Të gjithë elementët e tavolinës duhet të jenë të punuara me harqe për të evituar dëmtime të ndryshme të fëmijëve. Në këtë tavolinë është përlogaritur të ulen katër fëmijë. Materiali i skeletit tub i rumbullakët 32 mm dhe 30x20 mm korniza mbajtëse e syprinës, për të shmangur gërvishtjet e fëmijëve, i lyster me pudër elektrostatische. Pjesët mbështetëse të këmbëve duhet të jenë me tapa plastike. Syprina e saj MDF e laminuar me trashësi 18 mm, veshja perimetrale me ABC ose gominë të rumbullakosur. I gjithë montimi i saj bëhet në pjesët e fshehura të skeletit, të mbuluara me tapa plastike. Asnjë material nuk duhet të jetë alergjik dhe i dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.



9. Karrige për Fëmijët e Çerdhes

Karrige druri për fëmijë të moshës së çerdhes me tri përmasa të ndryshme në lartësinë e ndenjësës: gjerësi 39cm, thellësi 36cm, lartësi totale 67cm, lartësi e ndenjësës 26 cm, 31 cm dhe 34 cm, dhe thellësi e ndenjësës 26 cm. Të gjithë elementët e karriges duhet të jenë të punuar me harqe për të evituar dëmtime të ndryshme të fëmijëve. Kjo karrige duhet të ketë ngjyrë druri natyral. Materialet që duhet të përdoren në prodhimin e karriges nuk duhet të jenë alergjik dhe të dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.




10. Govatë e pajisur me tavolinë ndërrimi për fëmijët e çerdhes

Govatë që shërben për larjen, tharjen dhe veshjen e fëmijëve të moshës së çerdhes, nga 0-12 muajsh. Pjesa e sipërme e tavolinës është e veshur me material të butë dhe të papërshkueshëm nga uji, me pjesët anësore të ngritura për të siguruar fëmijët. Pjesa e govatës është shumë komode me formë anatomike, me shtresë të gomuar në pjesën fundore.



11. Krevat për Fëmijët e Çerdhes

Krevat për fëmijë të moshës së çerdhes me përmasa: gjerësi 56cm, gjatësi 132cm dhe lartësi 15 cm. Struktura është e ndërtuar me tuba çeliku, ndërsa pjesa ku shtrihen fëmijët është material tip rrjete. Kjo strukturë shërben për vendosjen një mbi një të krevateve dhe spostimin e tyre lehtësisht. Të gjithë elementët e krevatit duhet të jenë të punuar me harqe për të evituar dëmtime të ndryshme të fëmijëve. Materialet që duhet të përdoren në prodhimin e krevatit nuk duhet të jenë alergjik dhe të dëmshëm për shëndetin e fëmijëve.



12. Kosh "play-station"

Kosh plastik për t'i siguruar fëmijëve të moshës së çerdhës (0+) një kënd ku mund të lozin të mbrojtur, përkatësisht me përmasa: 100cmx 90cmx75cm. Ky kosh duhet të ketë pjesët anësore me rrjetë për të evituar dëmtimet e fëmijëve dhe të mund të mbyllet në rastet kur nuk përdoret. Materialet e koshit duhet të jenë ekologjike, joalergjik, higjienik dhe të mos e irritojnë lëkurën e fëmijës.



13. Tapet "puzzle"

Tapet për fëmijë të moshës së çerdhes (0+), me përmasa totale: 60cmx60cmx1cm. Ky tapet mundëson fëmijët të lozin në të duke e çmontuar dhe montuar përsëri me forma nga më të ndryshmet. Është i lehtë në përdorim dhe i lehtë në pastrim. Materialet e tapetit duhet të jenë ekologjike, joalergjike, jo-toksike, higjenike, pa aromë dhe të mos e irritojnë lëkurën e fëmijës. Ky tapet nuk është i rrëshqitshëm.



14. Komplet banak për kuzhinë

3.2 ml banak+ kontrabanak dhe 3.6 ml banak+0.7 m2 ishull



15. Lavapjate inoksi me 2 gropa+aksesoret (rubinet,sifone,etj.)

Lavapjatë, 2 gropa, majtas ose djathtas, inoks, argjendi, 116x50xH19 cm



16. Aspirator

Aspirator kuzhine, 180 W, 600 m³/h, 220 - 240 V / 50 - 60 Hz, 65 dB, filtër alumini, W51.4xH21.5xD26 cm



17. Frigorifer 2 kapakësh

Frigoriferi i pajisur me raftë të lëvizshme të rehatshme, me ballkone të lëvizshme, ndriçim LED, me sirtarin e madh të frutave dhe perimeve. Ndarja e ngrirësit, me të njëjtën linjë estetike si ndarja e frigoriferit.



18. Lavatriçe (10 kg)

Klasi i efikasitetit të tharjes: N/A. Lloji i materialit të kazanit: Inoks. Lartësia: 85 cm. Klasi i energjisë: A+++ -40%. Thellësia: 53 cm. Klasi i efikasitetit të larjes: A. Kapaciteti: 10 kg. Gjerësia: 59.5 cm. Niveli i zhurmës: 54/69 dB. Numri i rrotullimeve në minutë: 1400 rpm



19. Tharëse profesionale

Klasi i efikasitetit të tharjes: A. Lloji i materialit të kazanit: Inoks. Lartësia: 84.6 cm. Klasi i energjisë: A++. Thellësia: 54.3 cm. Klasi i efikasitetit të larjes: N/A. Kapaciteti: 8 kg. Gjerësia: 60 cm. Niveli i zhurmës: 64 dB. Programe tharje: 15. Numri i rrotullimeve në minutë: N/A



20. Kondicioner

Përmasat: N/A. Niveli i zhurmës: 55/61 dB. Sipërfaqja që mbulon: 22 m² - 30 m². Konsumi i energjisë në ftohje: 1.539 kW. Konsumi i energjisë në ngrohje: 1.48 W. Fuqia: 18000 BTU. Kapaciteti ftohës: 6.13 kW. Kapaciteti i ngrohjes: 6.74 kW. Klasi i energjisë: A++/A+. Vëllimi i ajrit: 670 m³/h. Lloji i gazit: R32. Tensioni: 220-240 V



21. Raft për dokumentacion

Thellësia: 41 cm. Materiali: Melaminë. Lartësia: 192 cm. Gjerësia: 80 cm



22. Tavolinë për drejtorin

Lartësia: 75 cm. Thellësia: 150 cm. Materiali: Melaminë. Gjerësia: 160 cm

